

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, NË MBLEDHJEN E “BIZNES ALBANIA”

30 shtator 2011

Faleminderit për ftesën, z. Bregasi, Biznes Albania!

Diskutimi ku na keni ftuar është shumë i rëndësishëm. Unë jam sot këtu bashkë me Darcie Nielsen, Shefe e Departamentit të Mirëqeverisjes në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore. Qëllimi i OSBE-së, dhe unë mendoj që kjo është arsyeja pse jam ftuar këtu sot, është të asistojë në zhvillimin e Shtetit të së Drejtës. Kjo do të thotë të ndihmojë zhvillimin e biznesit të lirë dhe konkurrent, jo vetëm për të gjeneruar fitime, por edhe për të ndihmuar në zhvillimin e vendit.

Ju përmendët se e kuptoni çfarë do të thotë të jesh i bashkuar, sa vlerë ka të qenit të bashkuar dhe një partner në diskutimet me qeverinë dhe parlamentin. Ju treguat se e dini që dhomat e tregtisë, veçanërisht dhomat bilaterale të tregtisë në Shqipëri, janë aktorë të rëndësishëm bashkë me ambasadat përkatëse për të qenë kontakt shkëmbimi për eksporte më të mira dhe lidhje ndërkombëtare biznesi. Të gjithë vendet që u përmendën janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, ashtu si edhe Shqipëria, dhe ne të gjithë mbështesim Shtetin e të Drejtës, çfarë ndihmon edhe në zhvillimin e biznesit.

Edukimi është gjithashtu një element i rëndësishëm për integrimin në strukturat Evropiane. Dëshiroj të kujtoj që edukimi nuk vjen vetëm nga shteti, por fillon në familje, në shoqëri, si edhe nga sipërmarrjet. Integrimi në botën globale dhe në Evropë janë objektiva kryesore për Shqipërinë, ndaj dhe duhen marrë hapa të rëndësishëm, e një prej tyre është edhe gjykata administrative.

Jam i sigurt që ju këtu në Biznes Albania do të bëni hapa për të lehtësuar biznesin, edhe për të zgjidhur problemet ende të hapura.

Rëndësi të madhe ka respektimi i ligjit, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe për të pasur një proces sa më transparent. Një shembull i rëndësishëm janë tenderët publik apo lejet e ndërtimit, apo koncesionet. Është një listë e gjatë. Rëndësi ka që të jetë një situatë konkurruese dhe ku të gjitha palët të dalin të fituara.

Si për një individ edhe për një biznes ka rëndësi që të ketë fitime për të mbijetuar dhe për të qenë konkurrues, dhe ky është edhe emri i lojës. Por në afat gjatë fitimi më i mirë është ai që arrihet në përputhje me Shtetin e të Drejtës.

Më duket inkurajuese ecuria e zhvillimit të ekonomisë në Shqipëri me sipërmarrje të lira. Sapo kam marrë pjesë në një diskutim të organizuar nga një fondacion politik, Fondacioni Conrad Adenauer Stiftung, në lidhje me të kaluarën në Gjermani. Ndaj përfitoj nga rasti për të theksuar rëndësinë e përfshirjes së biznesit të lirë në politikat e një vendi të lirë si Shqipëria. Kjo liri nuk është liri absolute, por duhet të bazohet në rregulla dhe kjo është ajo me çfarë asiston Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Nëpërmjet unitetit dhe dialogut mund të organizoni këtë progres dhe unë ju ftoj të vazhdoni dialogun. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e biznesit tuaj, në zhvillimin e Biznes Albania dhe të vendit ku mua më pëlqen të punoj.

Ju uroj punë të mbarë dhe suksese në sipërmarrjet që përfaqësoni.

Faleminderit!

Fund